

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 16.04.2017]

Për: Operatorin Ekonomik "ANK" shpk

Procedura e prokurimit: "Tender i Hapur" me objekt: "Sistemim Asfaltim Rruga Qafë Pllocë-Pogradec dhe Unaza Pogradec".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Sistemim Asfaltim Rruga Qafë Pllocë-Pogradec dhe Unaza Pogradec".

Kohëzgjatja: brënda 18 muajsh nga data e fillimit të punimeve.

Fondi limit: 1.067.180.235 (një miliard e gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 208.333.333 (dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 06.03.2017.

Publikimet më parshme (nëse zbatohet): Nuk kapatur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT
1	REJ & BITUPAVE	
2	GENER 2	
3	Victoria Invest International & VICTORIA INVEST &	
4	DELIA GROUP & MANETSI	
5	CURRI	
6	ALKO-IMPEX General Construcion	
7	AGBES KONSTRUKSION & ULEZA NDERTIM	
8	A. N. K.	
9	ARIFAJ & NTP EUROKOS & DENIS 05	
10	PE - VLA - KU & ALBA KONSTRUKSION	
11	GECI & VAGALAT	
12	BAMI	
13	G.P.G. COMPANY	
14	Ali Hyko	NUK KA OFERTE
15	VARAKU E	NUK KA OFERTE

Pas vleresimit të dokumentacionit të paraqitur (përfshirë rivlerësimin) komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikojë bashkimin e perkohshëm të shoqërive "Rej" shpk (3%), dhe "Bitupave" (97%) për arsye se:

Shoqëria "Bitupave" nuk plotëson pikën 2.3.7 për kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë persiper gjithë punimet për shtresat rrugore dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për disponimin e:

Grejder – 2 copë

Fabrikëasfalti – 1 copë

Asfalto-shtruese – 1 copë

Kompresor – 1 copë

Buldozer – 2 copë

Keto mjete jane te domosdoshem per realizimin e punimeve qe kjo shoqeri ka marre persiper. Vihet re se ne kontraten e bashkepunimit nuk cilesohet se mjetet qe disponon shoqeria "Rej" shpk do te mund te perdoren edhe nga shoqeria "Bitupave".

Shoqeria "Bitupave" nuk ploteson piken 2.3.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me xhiron mesatare te realizuar ne tre vitet e fundit pasi dokumenti i paraqitur per shoqerine meme nuk eshte i apostiluar ne perputhje me ligjin.

Shoqeria "Bitupave" nuk ploteson piken 2.2.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi dokumenti i paraqitur per shoqerine meme nuk eshte i apostiluar ne perputhje me ligjin.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje shoqerine "Gener 2" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

"Rehabilitation of access roads". Puna eshte realizuar nga shoqeria "Gener 2" shpk dhe "Sicilsaldo" spa. Kjo pune nuk permbush kriteret per tu konsideruar si pune e ngjashme pasi formulari i vleresimit nuk permban vleren e objektit dhe perqindjen e shoqerise "Gener 2" shpk ne realizimin e kesaj pune. Gjithashtu per kete objekt nuk eshte paraqitur asnje fature tatimore.

"By pass plepa Kavaje, loti 8". Kontrata eshte lidhur ne daten 01.08.2011 me vlere 874.510.350 leke me tvsh dhe eshte realizuar nga "Gener 2" shpk 50%, "Alb Star" shpk 30% dhe "Gjukuria" shpk 20%. Kolaudimi i objektit eshte bere ne daten 25.11.2015. Vlera e punes se kryer nga shoqeria "Gener 2" shpk ne kete objekt eshte 364.379.312 leke pa tvsh. Shoqeria "Gener 2" shpk duhet te kishte paraqitur dokumentacion per relizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 533.590.117 leke. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk permbush kerkesen per kualifikim.

"Rruga e Arbrit". Kontrata eshte lidhur ne daten 06.05.2011 me vlere 2.332.963.024 leke me tvsh dhe eshte realizuar nga "Gener 2", me afat 20 muaj. Kolaudimi i objektit eshte bere ne daten 05.08.2013. Objekti eshte jashte afatit 3 vjecar dhe ne kete menyre nuk permbush kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson piken 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi:

Rruli bomag BW225D-3 i mare me qera nga "Elmazaj Konstruksion" shpk i eshte dhene njekohesisht me qera firmes "Shendelli" shpk e cila e ka deklaruar si te pa angazhuar ne tenderin ne proces vleresimi "Rikonstruksioni i rrugëve 2; 3; 4 dhe paralele në Golem, Kavajë".

Rruli HAM 35020 i mare me qera nga "Elmazaj Konstruksion" shpk i eshte dhene njekohesisht me qera firmes "Shendelli" shpk e cila e ka deklaruar si te pa angazhuar ne tenderin ne proces vleresimi "Sistemim Asfaltim Rruga Qafë Pllocë-Pogradec dhe Unaza Pogradec".

Rruli DYNPAC CH602 i mare me qera nga "Elmazaj Konstruksion" shpk i eshte dhene njekohesisht me qera firmes "Uleza Ndertim" shpk e cila e ka deklaruar si te pa angazhuar ne tenderin ne proces vleresimi "Sistemim Asfaltim Rruga Qafë Pllocë-Pogradec dhe Unaza Pogradec".

Autobitumatrice Iveco AA572FL mare me qera nga "Rroku Guest" shpk eshte paraqitur si e lire nga vete shoqeria "Rroku Guest" shpk ne tenderin "Ndertim i unazes se qytetit bashkia Vau Dejes".

Mjetet autobetoniere AA743JD, TR4105R, AA136FS dhe AA145CZ mare me qera nga "Ferro Beton" shpk i jane dhene njekohesisht me qera firmes "Garden Line" shpk e cila i ka deklaruar si te pa angazhuara ne tenderin ne proces vleresimi "Rehabilitim dhe veshje me asfalt i rruges Fushe Arrez (K/Hadroit) – Reps (Rotonda)"

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Viktoria Invest International" shpk (43.875%), "Victoria Invest" shpk (30.584%) dhe "Al-Asfalt" shpk (25.541%) per arsye se:

Shoqeria "Viktoria Invest International" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Tirane nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria "Viktoria Invest" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Librazhd (ne objektin "Rikualifikim urban, zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore", me vlere 82.200.510 leke) dhe ne Bilisht (ne objektin "Rikualifikim urban i qendres se qytetit Bilisht, loti i", me vlere 102.536.108 leke. Per keto dy objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk i ka regjistruar ne QKB.

Shoqeria "Viktoria Invest International" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi per te vertetuar plotesimin e kriterit ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve:

"Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafe Stude loti 3". Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 06.05.2011 dhe puna eshte perfunduar ne daten 30.09.2015. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 2.270.873.995 leke.

"Rikonstruksion i rruges Grekan – Deshiran – Vlashuk (Kozare)". Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 27.12.2012 dhe puna eshte perfunduar ne daten 20.11.2014. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 454.641.388 leke.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin "Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafe Stude loti 3", rezulton se ankimuesi ka paraqitur, krahas kontratave dhe dokumentacionit tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2011 deri 2015, Komisioni konsideron si pune te kryer brenda tre viteve te fundit ate pjese te punes qe eshte realizuara pas dates 06.03.2014 (pasi tenderi qe shqyrtohet eshte hapur ne daten 06.03.2017). Referuar faturave tatimore vlere e punes se kryer gjate tre viteve te fundit per kete objekt eshte 139.915.701 leke pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin "Rikonstruksion i rruges Grekan – Deshiran – Vlashuk (Kozare)", rezulton se ankimuesi ka paraqitur, krahas kontratave dhe dokumentacionit tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2013 deri 2015, Komisioni konsideron si pune te kryer brenda tre viteve te fundit ate pjese te punes qe eshte realizuara pas dates 06.03.2014 (pasi tenderi qe shqyrtohet eshte hapur ne daten 06.03.2017). Referuar faturave tatimore vlere e punes se kryer gjate tre viteve te fundit per kete objekt eshte 160.818.672 leke pa tvsh.

Duke qene se shoqeria “Viktoria Invest International” shpk eshte shoqeria qe do te kryeje perqindjen me te madhe te punes (43,875%), duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 533.590.117 leke pa tvsh te realizuara ne nje objekt te vetem ose per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 936.450.656 leke pa tvsh te realizuar ne shume objekte. Kjo shoqeri nuk realizon asnje prej kushteve te mesiperm dhe ne kete menyre nuk ploteson kete kerkese per kaulifikim.

Shoqeria “Viktoria Invest” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi per te vertetuar plotesimin e kriterit ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve:

“Sistemim Asfaltim i Rruges Qemal Stafa...”. Per kete objekt puna ka filluar ne daten 11.07.2014 dhe eshte perfunduar ne daten 24.03.2015. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 100.663.850 leke.

“Rikualifikim urban i bllokut mbi shina...”. Per kete objekt puna ka filluar ne daten 26.08.2013 dhe puna eshte perfunduar ne daten 26.08.2015. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 208.303.692 leke.

Komisioni konstaton se nje pjese e puneve te mesiperme eshte realizuar jashte tre viteve te fundit. Per te percaktuar vleren e punes se realizuar ne tre vitet e fundit komisioni ju referua Vendimit 885/2016 date 21.11.2016 te Komisionit te Prokurimit Publik per nje rast te ngjashem. Ne kete vendim Komisioni i Prokurimit Publik i referohet vleres se punimeve te faturuara gjate tre viteve te fundit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin “Sistemim Asfaltim i Rruges Qemal Stafa...”, rezulton se vlera e plote pa tvsh e kesaj pune eshte 83.886.541 leke.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin “Rikualifikim urban i bllokut mbi shina...”, rezulton se ankimuesi ka paraqitur, krahas kontratave dhe dokumentacionit tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2013 deri 2016. Komisioni konsideron si pune te kryer brenda tre viteve te fundit ate pjese te punes qe eshte realizuara pas dates 06.03.2014 (pasi tenderi qe shqyrtohet eshte hapur ne daten 06.03.2017). Referuar faturave tatimore vlera e punes se kryer gjate tre viteve te fundit per kete objekt eshte 155.165.192 leke pa tvsh.

Duke qene se shoqeria “Viktoria Invest” shpk ka marre persiper te kryeje 30,584% te punimeve, duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 163.193.202 leke pa tvsh te realizuara ne nje objekt te vetem ose per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 652.772.806 leke pa tvsh te realizuar ne shume objekte. Kjo shoqeri nuk realizon asnje prej kushteve te mesiperm dhe ne kete menyre nuk ploteson kete kerkese per kaulifikim.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Delia Group” shpk (27%) dhe “Mane TCI” shpk (73%) per arsye se:

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje kamioncine.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ka paraqitur formularin e deklarimit te mjeteve.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Infrastruktura rrugore dhe rrjeti i jashtem inxhinierik ne kompleksin Rolling Hills”. Punimet kane filluar ne vitin 2009. Per kete objekt mungon formualri i vleresimit i percaktuar ne kerkesat per

kualifikim. Vlera totale e objektit (referuar aktit te kolaudimit) eshte 1.284.225.319 leke me tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur komisioni verejti se punimet e kryera jane kryesisht punime ndertimore (punime betoni etj) dhe nuk kane ngjashmeri me punimet rrugore qe prokurohen me proceduren aktuale.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin mesatar te te punesuarve pasi numri mesatar i deklaruar eshte 114 persona nga 117 qe duhet te ishte sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper te kryeje.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje inxhinier ndertimi dhe nje inxhinier ndertimi i profilit transport.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje shoqerine “Curri” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me xhiron mesatare te tre viteve te fundit pasi xhiro mesatare e deklaruar ne tender eshte 951.085.149 leke, pra me e vogel se 1.067.180.235 leke qe eshte vlera e fondit limit. Ne kete menyre nuk plotesohet kerkesa per kualifikim.

Nuk ploteson piken 2.2.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi disponon ne banke 100.000.000 leke, me pak se shuma 10% e fondit limit ose 106.718.023 leke e kerkuar ne dokumentet e tenderit.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Alko Impex General Construcion” shpk (85%) dhe “Agri Konstruksion” shpk (15%) per arsye se:

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Librazhd, Devoll, Koplik dhe Kavaje nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve me vlere punimesh si me poshte:

“Ndertimi i rruges tranzite per Shale” me vlere 472.011.867 leke.

“Sistemim asfaltim i rruges Qemal Stafa....” Elbasan me vlere 24.365.320 leke.

“Sistemim asfaltim rruge....” Librazhd me vlere 58.997.041 leke.

Vlera e plote e punes se kryer ne tre vitet e fundit ne objektin me te madh te deklaruar “Ruga tranzite per shale” eshte 472.011.867 leke pa tvsh dhe nuk ploteson kushtin si nje pune e vetme. Vlera totale e puneve te deklaruar eshte 555.374.227 leke dhe nuk ploteson kushtin e dokumentave te tenderit per vleren e puneve te marra se bashku.

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Agbes Konstruksion” shpk (76%) dhe “Uleza Ndertim” shpk (24%) per arsye se:

Bashkimi i shoqerive nuk ka te punesuar dy inxhinier ndertimi me profilin transport, sic eshte kerkuar ne dokumentet e tenderit, por vetem nje te deklaruar nga shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk. Shoqeria tjeter “Uleza Ndertim” ka paraqitur dokumentet e ing Luan R. i cili eshte diplomuar ne vitin 1974 si inxhinier ndertimi. Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk, me nje deklarate te ngarkuar ne sistem, pretendon se ing Luan R. eshte njekohesisht edhe inxhinier ndertimi me profil transport, pasi ne kohen qe ai ka mbaruar studimet profili transport ishte i perfshire. Kjo deklarate eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe shoqeria duhet te kishte punesuar per kete qellim nje inxhinier ndertimi me profilin transport, si shume shoqeri te tjera ofertuese. Ne perfundim, shoqeria “Uleza Ndertim” shpk ka marre persiper te kryeje punime rrugore dhe nuk ka te punesuar inxhnier ndertimi me profil transport, ajo duhet te skualifikohet. Per kryerjen e ketyre punimeve ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Puke, Mirdite dhe Kurbin nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Ne kete menyre edhe deklarimi per shlyerjen e te gjitha detyrimeve te taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016 rezulton i rreme.

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi referuar marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper punime per shtresat rrugore dhe nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per disponimin e:

Gurëthyes, frontoje – 1 copë

Fabrikëasfalti – 1 copë

Implantautomatikbetoni – 1 copë

Furçemekanikepërpastrim(fshese) – 1 copë

Frezeasfalti – 1 copë

Keto mjete jane te domosdoshem per realizimin e punimeve qe kjo shoqeri ka marre persiper. Vihet re se ne kontraten e bashkepunimit nuk cilesohet se mjetet qe disponon shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk do te mund te perdoren edhe nga shoqeria “Uleza Ndertim” shpk.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “NTP Eurokos” shpk (51%), “Arifaj” shpk (45.5%) dhe “Denisi 05” shpk (3.5%) per arsye se:

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Vlore dhe Elbasan - Librazhd nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profil transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime rrugore ne te cilat ky specialitet eshte i domosdoshem.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje shoqerine "Bami" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me xhiron mesatare te tre viteve te fundit pasi xhiro mesatare e deklaruar ne tender eshte 595.912.393 leke, pra me e vogel se 1.067.180.235 leke qe eshte vlere e fondit limit. Ne kete menyre nuk plotesohet kerkesa per kualifikim.

Nuk ploteson piken 2.2.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi disponon ne banke 79.236.324 leke, me pak se shuma 10% e fondit limit ose 106.718.023 leke e kerkuar ne dokumentet e tenderit.

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me realizimin e puneve te ngjashme, pasi vlere totale e punes se ngjashme e deklaruar ne tender eshte 606.848.490 leke me tvsh, nga te cilat shoqeria "Bami" shpk ka realizuar 30%. Vlere e realizuar nga "Bami" shpk eshte 151.712.122 leke pa tvsh duke mos permbushur kerkesen per kualifikim. Kontrata e nensipermarrjes e lidhur ndermjet "Bami" shpk dhe "Geci" shpk eshte e jashteligjshme, pasi legjislacioni i prokurimit publik lejon te nenkontraktohet jo me shume se 40% e vleres se kontrates, edhe kjo pas miratimit te autoritetit kontraktor.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje shoqerine "GPG" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Korce nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

Rruga Lushnje Berat Loti 1, zbatuar gjate viteve 2011-2014, me vlere te plote 408.866.477 leke pa tvsh.

Rruga Lushnje Hygjokaj, zbatuar gjate viteve 2013 – 2014, me vlere te plote te realizuar nga shoqeria "G.P.G." shpk 336.486.270 leke pa tvsh.

Me keto dy pune nuk ploteson kerkesen per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 533.590.117 leke pa tvsh ose te shume puneve me vlere te pergjithshme 2.134.360.470 leke pa tvsh

Te skualifikoje shoqerine "Ali Hyka" shpk per arsye se nuk ka paraqitur asnje dokumentacion.

Te skualifikoje shoqerine "Varaku E" shpk per arsye se nuk ka paraqitur asnje dokumentacion.

Duke i referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik "ANK" shpk se oferta e paraqitur, me vlerë 891.004.420 (teteqind e nentëdhjetë e një milion e katërmijë e katërqind e njëzet) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit

- Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania
- Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)
- Fax: 00355 4 2 234 885

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.03.2017.

Nedaten 29.03.2017 paraqitiankese per vleresiminshoqeria “Victoria Invest International” shpk.Ankesesjukturthyepergjigje ne daten 04.04.2017.

Nedaten 30.03.2017 paraqitiankese per vleresiminshoqeria “AlkoImpex General Construction” shpk.Ankesesjukturthyepergjigje ne daten 05.04.2017.

